

SHOQATA E KONTABILISTËVE DHE FINANCIERËVE TË SHQIPËRISË

**RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE AKTIVITETIN E ORGANEVE DREJTUESE DHE DEGËVE
TË SHOQATËS**

Funksioni propozues	Këshilli Drejtues
Funksioni aprovues	Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve
Data e aprovimit	24.10.2020

I. HYRJE

1. Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë (SH.K.F.SH.) synon një administrim efektiv të punëve dhe marrëdhënieve të saj me të gjitha palët e përfshira. Për këtë qëllim, veprimtaria e organeve drejtuese përfaqëson një dimension të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punëve të Shoqatës dhe arritjen e objektivave të saj.
2. Veprimtaria drejtuese bazohet në strukturën organizative të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve dhe reflektuar në Statutin e Shoqatës. Kjo rregullore është hartuar me qëllim që të përcaktojë qartazi marrëdhëniet ndërmjet organeve drejtuese, rolet dhe përgjegjësitë e tyre dhe nivelet e autoritetit dhe kompetencave të funksioneve të brendshme.
3. Kjo rregullore miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve dhe është subjekt rishikimi periodik, të vazhdueshëm, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së veprimtarisë së Shoqatës, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e eficiencës në përmbushjen e punëve të SH.K.F.SH.-së në funksion të misionit dhe objektivave të saj.

II. QËLLIMI I RREGULLORES DHE FUSHA E ZBATIMIT

1. Parashikimet e kësaj rregulloreje janë të zbatueshme sipas pozicioneve përkatëse nga të gjithë anëtarët e organeve drejtuese të SH.K.F.SH. dhe në nivel dege.
2. Qëllimi i rregullores është përcaktimi i veprimtarive dhe rolet e secilit organ në realizimin e veprimtarive të Shoqatës.
3. Kjo rregullore vendos bazën e mënyrave të ndërveprimit dhe shkëmbimit të informacionit mes roleve të ndryshme brenda Shoqatës, ndarjen e detyrave për të evituar përsëritje të punëve, evitimin e konflikteve mes funksioneve dhe mosmbatje të përgjegjësive përkatëse, si dhe vendos tagrat e autoritetit dhe kompetencat në nivel vertikal dhe horizontal, me qëllim arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të SH.K.F.SH.-së.
4. Në këtë rregullore përcaktohen, gjithashtu, përgjegjësitë dhe detyrat shtesë për Drejtorin Ekzekutiv në funksion të administrimit dhe monitorimit efektiv të çështjeve financiare, administrative dhe shërbimeve mbështetëse.

III. ORGANET DREJTUESE TË SHOQATËS

1. Organet drejtuese të SH.K.F.SH. janë:
 - a) Këshilli Drejtues;
 - b) Kryetari i Shoqatës;
 - c) Komitetet dhe Komisionet

- d) Komiteti i Kontrollit të Brendshëm;
 - e) Drejtori Ekzekutiv;
 - f) Degët në rrethe.
2. Struktura drejtuese të Shoqatës dhe organizimi i saj reflekton principet dhe kërkesat ligjore dhe një frymë bashkëkohore të organizimit, duke vendosur kështu një bazë themelore për arritjen e objektivave të Shoqatës.
 3. Organizimi efikas i Shoqatës nënkupton krijimin e një kulture pune dhe bashkëpunimi harmonik mes funksioneve të ndryshme brenda Shoqatës, si edhe konsolidon ushtrimin e shëndoshë të veprimtarive të Shoqatës, qoftë brenda saj, ashtu dhe në marrëdhënie me palë të treta.

IV. NDARJA E DETYRAVE

1. Të gjitha organet drejtuese janë nën varësinë dhe mbikëqyrjen e Këshillit Drejtues. Kjo marrëdhënie vertikale hierarkie kufizohet vetëm në raportet mes komisioneve e komiteteve dhe Drejtorit Ekzekutiv, ku të parët shërbejnë si drejtues të veprimtarisë përkatëse që mbulojnë dhe ku Drejtori Ekzekutiv shërben si përgjegjës i çështjeve financiare dhe administrative të Shoqatës.
2. Komitetet dhe komisionet mbulojnë veprimtaritë e posaçme përkatëse dhe nuk interferojnë në punët e njëri-tjetrit, përveçse për të shkëmbyer informacion në përputhje me parashikimet e brendshme rregullatore.
3. Çdo organ drejtues ka rolin e vet të përcaktuar sipas Statutit, nëpërmjet kësaj rregulloreje apo rregulloreve të posaçme për komitetet dhe komisionet e posaçme të Shoqatës dhe bashkëveprojnë ndërmjet tyre për arritjen e qëllimeve të Shoqatës, duke kontribuar secili sipas funksionit dhe fushës përkatëse.
4. Autoriteti dhe kufijtë e kompetencave të komiteteve dhe komisioneve janë të përcaktuara në Statutin e Shoqatës dhe në rregulloret e miratuara të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, komplementare me parashikimet e kësaj rregulloreje.

V. ZBATIMI I PËRGJEGJËSIVE

1. Përgjegjësitë kryesore ushtrohen nëpërmjet zbatimit të rregullave të brendshme dhe dhënies së autorizimeve për përmbushjen e detyrave, regjistrimin dhe dokumentimin e veprimtarisë dhe bashkërendimin /verifikimin e veprimtarive për çdo proces pune të Shoqatës.

2. Si rregull, përgjegjësitë kryesore realizohen nga Këshilli Drejtues i Shoqatës ose nga komiteti, komisionet dhe personat, të cilëve u delegohen shprehimisht përgjegjësitë kryesore, ose kur këto përgjegjësi kryesore realizohen në bazë të një akti të brendshëm të aprovuar prej Asamblesë së Anëtarëve ose Këshillit Drejtues, sipas rastit.
3. Detyrat i prezantohen qartësisht dhe në mënyrë të kuptueshme çdo organi dhe anëtari që në momentin e emërimit, por edhe në vijim; ndërmerren hapa të tjerë konkretë, për t'u mundësuar atyre informim të plotë dhe të detajuar mbi ndryshime të mundshme të detyrave, roleve, përgjegjësive apo organeve të varësisë.

VI. PËRBËRJA DHE ROLET NË KËSHILLIN DREJTUES

1. Këshilli Drejtues përbëhet nga nëntë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme Vjetore. Këshilli organizohet dhe funksionon sipas kësaj strukture:
 - a) Kryetari i Këshillit, që është Kryetari i Shoqatës, i zgjedhur nga Asambleja;
 - b) Zëvendëskryetari;
 - c) Anëtarë përgjegjës për çështje të tjera, të ndara sipas fushës profesionale.
2. Kryetari i Këshillit Drejtues zgjidhet me votim të drejtpërdrejtë nga Asambleja e Përgjithshme Vjetore, e cila, në të njëjtën mbledhje, zgjedh edhe tetë anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues. Kryetari ka mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.
3. Zëvendëskryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit Drejtues, të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues zgjidhen për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm pas kalimit të një afati katërvjeçar nga përfundimi i mandatit.
4. Më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit Drejtues duhet të jenë Kontabilistë të Miratuar Aktivë. Anëtar i Këshillit Drejtues mund të zgjidhet një anëtar i Shoqatës, që plotëson kushtet që vijojnë:
 - a) gëzon shëndet dhe aftësi të plota, pa të cilat ushtrimi i detyrave në Këshillin Drejtues do të ishte i pamundur;
 - b) nuk është marrë kundër tij/saj asnjë masë disiplinore, që e përjashton atë nga anëtarësia në Shoqatë;
 - c) në datën e paraqitjes së kërkesës/kandidaturës për të marrë pjesë në zgjedhje, kandidati rezulton se ka paguar kuotat e anëtarësisë apo edhe çdo detyrim tjetër ndaj Shoqatës;

- d) gjatë periudhës katërvjeçare para paraqitjes së kërkesës/kandidaturës për të marrë pjesë në zgjedhje, nuk ka qenë subjekt i masave disiplinore/ndëshkuese të marra nga Shoqata, nga organet publike apo gjykatat në lidhje me ushtrimin e veprimtarive në fushën e kontabilitetit apo fushave të tjera të lidhura me të.

VII. PROCEDURA PËRZGJEDHJES SË KËSHILLIT DREJTUES

1. Çdo anëtar i interesuar që plotëson kushtet, mund të depozitojë dosjen e kandidatit për t'u zgjedhur në Këshillin Drejtues, duke paraqitur kërkesë pranë Drejtorit Ekzekutiv, jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë nga data e caktuar për mbajtjen e Mbledhjes së Asamblesë përkatëse.
2. Kërkesa duhet shoqëruar me firmat e të paktën dhjetë anëtarëve të Shoqatës. Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë të paraqesin kërkesë individuale për kandidimin e tyre për rizgjedhje.
3. Në mbledhjen e Asamblesë mund të paraqesë një listë kandidaturash Këshilli Drejtues, të cilat i vihen në dispozicion Drejtorit Ekzekutiv, të formalizuara me një vendim të tij.
4. Kandidaturat i paraqiten me shkrim Drejtorit Ekzekutiv brenda një afati prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e caktuar për mbajtjen e Mbledhjes së Asamblesë dhe mbajnë nënshkrimin e Kryetarit të Këshillit Drejtues për kandidatuarat e Këshillit ose nënshkrimin e të gjithë anëtarëve propozues për kandidaturat e paraqitura nga dhjetë ose më shumë anëtarë.
5. Lista e kandidatëve për t'u zgjedhur anëtarë të Këshillit Drejtues, e cila përmban emrin dhe adresën e kandidatëve, përgatitet nga Drejtori Ekzekutiv dhe miratohet nga Këshilli Drejtues.
6. Lista u njoftohet të gjithë anëtarëve jo më vonë se dhjetë ditë para datës së caktuar për Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore të radhës.
7. Zgjedhjet e anëtarëve të Këshillit Drejtues në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme Vjetore bëhen me votim të fshehtë.
8. Çdo anëtar me të drejtë vote voton për aq kandidatë (të ndryshëm) sa është numri i vendeve vakante në Këshillin Drejtues. Format i fletëve të votimit miratohet nga Këshilli Drejtues.
9. Kandidatët fitues në zgjedhjet e zhvilluara për anëtarë të Këshillit Drejtues janë ata që marrin numrin më të madh të votave të hedhura të vlefshme. Në rast barazimi votash mes dy anëtarëve

që kandidojnë për vendin vakant në Këshillin Drejtues, përzgjedhja e fituesit bëhet me short, në të njëjtën mbledhje, sipas mënyrës së vendosur nga Kryetari i Mbledhjes.

VIII. PLOTËSIMI I VENDEVE VAKANTE NË KËSHILLIN DREJTUES

1. Për plotësimin e vendeve vakante të krijuara në Këshillin Drejtues, për arsye dorëheqjeje apo tjetër, Këshilli Drejtues zgjedh ndër anëtarët e Shoqatës që plotësojnë kriteret për të qenë anëtarë të Këshillit kandidaturën, e cila, duke përjashtuar kandidatët fitues në mbledhjen e mëparshme, ka marrë numrin më të lartë të votave.
2. Anëtarët e zgjedhur si në pikën 1 qëndrojnë në detyrë deri në datën e mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë më të afërt, me të drejtë për t'u rizgjedhur prej asaj Asambleje. Në mbledhjen e asamblesë më të afërt parashikohet si çështje për votim në zgjedhja e anëtarit/ve për plotësimin e vendit vakant në Këshillin Drejtues, duke zbatuar parashikimet përkatëse të Statutit.

IX. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KËSHILLIT DREJTUES

1. Këshilli Drejtues kryen drejtimin e veprimtarisë, në pajtim me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, së cilës edhe i raporton për veprimtarinë e tij, dhe është përgjegjës për sa më poshtë:
 - a) punon për arritjen e objektivave dhe misionit të Shoqatës;
 - b) miraton politikat e edukimit të vijueshëm si dhe mënyrën e organizimit, e monitorimit dhe të vlerësimit individual të kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve të saj, si dhe rregullat për regjistrimin dhe çregjistrimin e anëtarëve nga Regjistri i Kontabilistëve të Miratuar;
 - c) siguron mbarëvajtjen financiare të organizatës dhe ushtrimin e veprimtarisë së saj në përputhje me qëllimin e deklaruar;
 - d) përfaqëson Shoqatën nëpërmjet Kryetarit në marrëdhënie me subjektet, private ose publike, të tilla si donatorë, klientë furnizues apo subjekte të tjera private, organizata profesionale vendase dhe të huaja, si dhe me të gjitha nivelet e qeverisjes që rregullojnë veprimtarinë e Shoqatës;
 - e) krijon sistemin e kontrollit të cilësisë së punës së Kontabilistëve të Miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit dhe kryen investigime në rastet e shkeljeve të standardeve profesionale teknike dhe etike, si dhe udhëheq sistemin e investigimit e të disiplinës për aspekte të tjera brenda objektit të vet;
 - f) miraton listën përfundimtare të kandidaturave për zgjedhje në Këshillin Drejtues dhe Komitetin e Kontrollit të Brendshëm;

- g) miraton masën e kuotave të anëtarësisë dhe të tarifave të regjistrimit të aplikueshme nga Shoqata;
 - h) vendos dhënien e titujve honorifikë për anëtarët e shoqatës, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar për profesionin e kontabilitetit dhe shërbimeve të tjera të lidhura me to;
 - i) emëron, shkarkon dhe përcakton shpërblimin e Drejtorit Ekzekutiv të Shoqatës;
 - j) miraton politikat e edukimit të vijueshëm, si dhe mënyrën e organizimit, e monitorimit dhe të vlerësimit individual të kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve të Shoqatës;
 - k) miraton dhe mbikëqyr organizimin e testimit të njohurive të marra gjatë kualifikimeve të vijueshme;
 - l) miraton organizimin dhe programet e testimit të njohurive të marra gjatë kualifikimeve të vijueshme;
 - m) harton rregulloret dhe aktet e brendshme të Shoqatës për miratim nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve;
 - n) jep tituj nderi për profesionistë dhe kontribuues të dalluar në fushën e kontabilitetit apo fushave të lidhura me të;
 - o) propozon kandidatë përfaqësues të Shoqatës në struktura dhe funksione publike;
 - p) bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për të siguruar që organizatat partnere dhe ato që sigurojnë financim, shërbime dhe mbështetje materiale nuk përdoren apo manipulohen për qëllime terroriste;
 - q) kryen detyra të tjera të caktuara me ligj apo me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, ose kur kërkohet nga autoritetet publike, rregullatore të praktikës së kontabilitetit.
2. Këshilli Drejtues është gjithashtu përgjegjës për të implementuar procedura dhe procese, me qëllim funksionimin dhe kontrollimin e operacioneve të Shoqatës, përmbushjen e detyrave të organeve drejtuese dhe funksionimin optimal të Shoqatës në përmbushje të objektivave.
3. Kjo seri procedurash dhe procesesh duhet të jetë e tillë që Këshilli Drejtues t'i japë sigurinë dhe bindjen e nevojshme se:
- a) informacioni dhe të dhënat e publikuara, qoftë të brendshme apo të jashtme, janë të sakta, të besueshme dhe të përcjella brenda një kohe të arsyeshme, të shkurtër.
 - b) veprimet e komiteve, komisioneve, Drejtorit Ekzekutiv dhe shërbimeve mbështetëse janë në përputhje me politikat, standardet, planet dhe procedurat e Shoqatës, si dhe me të gjithë ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.
 - c) burimet/resurset e Shoqatës (përfshirë punonjësit, sistemet, bazat e të dhënave/informacioni) mbrohen dhe ruhen rregullisht.

- d) resurset merren/blihen me çmime të përshtatshme (ekonomike) dhe përdoren në mënyrë të frytshme;
 - e) proceset e biznesit janë cilësore dhe përmirësimi i vazhdueshëm i tyre është thelbësor për biznesin e Shoqatës.
 - f) planet, programet, objektivat dhe qëllimet e Shoqatës arrihen prej saj brenda afateve të parashikuara/përcaktuar.
4. Kontrollimi i proceseve dhe mbarëvajtjes së tyre është funksion i rëndësishëm i Këshillit Drejtues dhe përbën pjesë integrale të procesit të përgjithshëm të menaxhimit/administrimit të punëve të Shoqatës. Kjo përgjegjësi shtrihet dhe te drejtuesit e komisioneve/komiteteve sipas funksioneve përkatëse, të cilët së bashku me Drejtorin Ekzekutiv, janë përgjegjës për të:
- identifikuar dhe vlerësuar ekspozimet ndaj humbjeve që lidhen me fushat përkatëse të veprimtarisë.
 - specifikuar dhe përcaktuar planet, standardet, procedurat dhe sistemet operative, në mënyra që minimizohen, zbuten, dhe/ose kufizohen rreziqet e lidhura me ekspozimet e identifikuar.
 - të vendosin dhe ndjekin procese kontrolli praktike që nxisin dhe motivojnë përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi përkatëse nga të gjithë personat përgjegjës.
 - mirëmbajtur efektivitetin e proceseve të punës si më sipër dhe të kujdesen për përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.

X. ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT DREJTUES

1. Me kërkesë të Kryetarit, ose në mungesë të tij, të Zëvendëskryetarit, Këshilli Drejtues mbledhet sa herë që interesat e Shoqatës e kërkojnë, por si rregull katër herë në vit (një herë në çdo tre muaj).
2. Kryetari duhet të thërrasë Këshillin Drejtues brenda një afati të arsyeshëm kur një e treta e anëtarëve të Këshillit, me kërkesë të motivuar, i drejtohen Kryetarit për t'u takuar.
3. Njoftimet për mbledhjen përmendin rendin e ditës dhe pikat kryesore për diskutim. Në rast se Kryetari nuk arrin të thërrasë Këshillin Drejtues brenda dhjetë ditëve nga marrja e kërkesës, kërkuesit mund të thërrasin dhe të drejtojnë mbledhjen e Këshillit Drejtues, duke përcaktuar çështjet e rendit të ditës së mbledhjes.

4. Në rrethanat kur mbledhja e Këshillit Drejtues nuk mund të realizohet nëpërmjet takimit fizik të anëtarëve apo kur kjo nuk lejohet dhe nuk rekomandohet, mbledhja e Këshillit Drejtues zhvillohet nëpërmjet platformave online.
5. Mbledhjet e Këshillit Drejtues mbahen brenda Republikës së Shqipërisë, siç tregohet në njoftimin e mbledhjes, dhe mund të realizohen edhe nëpërmjet telekonferencës ose videokonferencës, ose me mjete të ngjashme elektronike, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të identifikohen dhe të komunikojnë në mënyrë qartë. Nëse plotësohen këto kushte, mbledhja e Këshillit konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari.
6. Procesverbalet e mbledhjeve mbahen nga sekretari i mbledhjes, që si rregull caktohet nga Drejtori Ekzekutiv, ose, në mungesë të tij, një anëtar i Shoqatës, i përzgjedhur nga Këshilli, dhe nënshkruhen nga ai/ajo dhe Kryetari, ose në mungesë të tij nga Zëvendëskryetari. Procesverbalet mbahen në regjistër të veçantë, të administruar nga Drejtori Ekzekutiv.

XI. VENDIMET E KËSHILLIT DREJTUES

1. Vendimet e Këshillit Drejtues janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje me shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
2. Vendimet e Këshillit Drejtues merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm dhe në rast barazimi, vota e Kryetarit është përcaktuese.
3. Vendimet e Këshillit Drejtues pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes dhe përbëjnë dokumente përfundimtare dhe të detyrueshme të Shoqatës. Anëtarët e Shoqatës informohen për vendimet e marra nga Këshilli Drejtues sipas mënyrës së përcaktuar nga Këshilli.

XII. KRYETARI I SHOQATËS

1. Kryetari i Këshillit Drejtues është njëkohësisht Kryetar i Shoqatës dhe përfaqësuesi ligjor i saj.
2. Kryetari promovon dhe bashkërendon veprimtaritë e Shoqatës dhe siguron që ajo të funksionojë mirë dhe në përmbushje të misionit të saj.
3. Kryetari i Shoqatës është organi që përfaqëson ligjërisht Shoqatën me palët e treta, vepron si përfaqësues zyrtar i Shoqatës gjatë takimeve dhe ngjarjeve zyrtare, si edhe, por pa u kufizuar, sa vijon:
 - a) thërret dhe kryeson mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe të Asamblesë së Përgjithshme;

- b) cakton agjendën vjetore të Shoqatës;
 - c) krijon buxhetin dhe menaxhon financat dhe pasuritë e Shoqatës;
 - d) nënshkruan dhe/ose kundërfirmos të gjitha aktet përkatëse të miratuara nga organet drejtuese të Shoqatës.
4. Në mungesë të Kryetarit të Këshillit Drejtues, Zëvendëskryetari e zëvendëson atë në detyrat e parashikuara në Statut, në këtë rregullore apo me vendim të Këshillit.

XIII. KOMITETET DHE KOMISIONET

1. Detyrat, përgjegjësitë, organizimi dhe funksionimi i komiteteve dhe komisioneve, për sa nuk parashikohet në këtë rregullore, janë ato të përcaktuara në rregulloret e posaçme për veprimtaritë përkatëse të secilit apo në Statutin e Shoqatës dhe akte të tjera të brendshme.
2. Detyrat, përbërja, organizimi dhe funksionimi i Komitetit të Regjistrimit, Komisionit Disiplinor, Komisionit të Kualifikimit të Vijuëshëm Profesional dhe Komisionit të Kontrollit të Cilësisë rregullohen me rregullore/akt më vete.

XIV. DREJTORI EKZEKUTIV

1. Drejtori Ekzekutiv siguron mbarëvajtjen e punëve administrative, mbulimin e tyre dhe të veprimtarive të tjera të Shoqatës në përputhje me rregullat e administrimit financiar të miratuara nga Këshilli Drejtues.
2. Drejtori ekzekutiv është përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera normative në veprimtarinë e Shoqatës që kanë të bëjnë me administrimin financiar të mjeteve në dispozicion të saj, mbulimin e çështjeve administrative të shoqatës dhe drejtimin e shërbimeve mbështetëse.
3. Drejtori Ekzekutiv, për përmbushjen e detyrave, mbështetet nga shërbimet mbështetëse, të cilët janë individë të punësuar pranë Shoqatës sipas ekspertizave profesionale të ndryshme.
4. Drejtori Ekzekutiv organizon punën për kryerjen e veprimtarive profesionale të Shoqatës, të cilat janë në përputhje me Ligjin apo me vendimet e Këshillit Drejtues, si dhe mbulon detyrat

e parashikuara në Statut dhe rregulloret e Këshillit Drejtues dhe veprimtarinë teknike e profesionale, në zbatim të programit të punës dhe të vendimeve të Këshillit Drejtues.

5. Drejtori Ekzekutiv raporton rregullisht para Këshillit Drejtues mbi gjendjen financiare të Shoqatës, realizimin e buxhetit shoqëruar me pasqyrat financiare periodike dhe për detyrat që i janë caktuar.
6. Drejtori Ekzekutiv, me kërkesë të Këshillit Drejtues, kryen detyra të tjera dhe që lidhen me veprimtarinë e Shoqatës.
7. Drejtori Ekzekutiv është punonjës me kontratë dhe shpërblehet për punët e kryera për Shoqatën sipas vendimit të Këshillit Drejtues.
8. Drejtori Ekzekutiv siguron mbarëvajtjen e proceseve operative dhe mbikëqyr ushtrimin e përgjegjësiave nga ana e shërbimeve mbështetëse.
9. Drejtori Ekzekutiv, në realizimin e detyrave të veta, sigurohet që:
 - g) informacioni dhe të dhënat e publikuara nga Shoqata, qoftë të brendshme apo të jashtme, janë të sakta, të besueshme dhe të përcjella brenda një kohe të arsyeshme, të shkurtër.
 - h) veprimet e administratorëve, drejtuesve të njësiave dhe punonjësve janë në përputhje me politikat, standardet, planet dhe procedurat e Shoqatës, si dhe me të gjitha ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.
 - i) burimet/resurset e Shoqatës (përfshirë punonjësit, sistemet, bazat e të dhënave/informacionit) mbrohen dhe ruhen rregullisht.
 - j) resurset merren/blihen me çmime të përshtatshme (ekonomike) dhe përdoren në mënyrë të frytshme;
 - k) proceset e biznesit janë cilësore dhe përmirësimi i vazhdueshëm i tyre është thelbësor për biznesin e Shoqatës.
 - l) planet, programet, objektivat dhe qëllimet e Shoqatës arrihen prej saj brenda afateve të parashikuara/përcaktuar.

XV. SHËRBIMET MBËSHTETËSE

1. Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv, në përmbushjen e detyrave respektive, mbështeten nga shërbimet mbështetëse, të tillë si: shërbimet IT, shërbimet ligjore, shërbimet e marketingut etj.
2. Personat e punësuar pranë shërbimeve mbështetëse mund të jenë anëtarë të Shoqatës, por jo detyrimisht.
3. Shërbimet mbështetëse ndahen në njësi pune sipas fushave të ekspertizës dhe drejtohen nga Drejtori Ekzekutiv. Ato u përgjigjen të gjithë kërkesave për kryerjen e punëve, që diktohen nga Kryetari i Shoqatës ose Drejtori Ekzekutiv.
4. Punonjësve të shërbimeve mbështetëse u caktohen detyra specifike, që janë përcaktuar dhe përshtatur herë pas here sipas nevojave të Shoqatës nga Këshilli Drejtues apo Drejtori Ekzekutiv.
5. Çdo njësi e shërbimeve mbështetëse ka një linje direkte raportimi pranë Administratorëve të Drejtorit Ekzekutiv dhe, në rastet kur kërkohet nga Kryetari, raportimi bëhet direkt pranë tij.
6. Detyrat e çdo të punësuar pranë shërbimeve mbështetëse përcaktohen në përshkrimin e punës të secilit (*job description*).
7. Përshkrimet e punëve hartohen dhe shpërndahen duke pasur parasysh mospërplasjen e funksioneve, detyrave dhe roleve të secilës njësi të shërbimeve mbështetëse.

XVI. ORGANIZIMI I DEGËVE TË SHOQATËS

1. Shoqata, me vendim të Këshillit Drejtues, mund të krijojë degë të saj në çdo njësi administrativo-territoriale të Shqipërisë, në përputhje me kompetencat e dhëna në Statutin e Shoqatës.
2. Këto degë nuk janë persona juridikë të veçantë, por pjesë e Shoqatës dhe kryejnë veprimtaritë që i caktohen nga Këshilli dhe organet drejtuese.
3. Degët e Shoqatës krijohen mbi bazë bashkie ose qarku kur brenda njësisë territoriale ndodhen mbi 10 anëtarë të Shoqatës, të cilët regjistrohen pranë degës përkatëse.
4. Anëtarët e Shoqatës të regjistruar në një degë formojnë Asamblenë e Degës, e cila mbledhet të paktën një herë në vit dhe thirret nga Kryetari i Degës, Këshilli Drejtues apo 1/3 e anëtarëve të Degës.

5. Asambleja e Degës ka këto kompetenca kryesore:
 - a) Zgjedh Kryetarin e Degës dhe Sekretarin e Degës;
 - b) Shqyrton dhe miraton raportin e funksionimit të Degës;
 - c) Mbikëqyr zbatimin e objektivave të degës dhe detyrave të Këshillit Drejtues brenda rajonit gjeografik që përfshin dega;
 - d) Organizon në bashkëpunim me Këshillin Drejtues dhe organet e tjera të saj, veprimtari dhe aktivitete që janë në përputhje me misionin dhe objektin e saj të veprimtarisë.
6. Rregullat e zgjedhjes në mbledhjen e Asamblesë së Degës dhe forma e votimit përcaktohen me vendim të Asamblesë së Degës, në përputhje me statutin.
7. Dega e Shoqatës drejtohet nga Kryetari i Degës, i cili ka mandat katërvjeçar me të drejtë përsëritje. Në çdo degë zgjidhet edhe një sekretar me shumicë të thjeshtë votash, me mandat katërvjeçar, me të drejtë përsëritjeje.
8. Kryetari i Degës është përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së Degës në përputhje me Statutin dhe rregulloret e Shoqatës dhe udhëzimet e Këshillit Drejtues. Sekretari është përgjegjës për mbajtjen e regjistrave dhe dokumentacionit në Degë.
9. Këshilli Drejtues vendos nën diskrecionin e vet fondet për mbulimin e shpenzimeve të degëve në përputhje me objektivat e Shoqatës.
10. Degët organizohen, veprojnë dhe administrohen në përputhje me Statutin dhe rregullat përkatëse të Asamblesë së Degës dhe Shoqatës.